



|                 |    |          |          |
|-----------------|----|----------|----------|
| FUNCTIONAL UNIT | 29 | Pr. No.  | 3087     |
| DATE            | 02 | Pr. Date | 25.11.21 |

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës – Ministarstvo Inostranih Poslova i Dijaspore -  
Ministry of Foreign Affairs and the Diaspora

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

|  |  |            |   |        |            |
|--|--|------------|---|--------|------------|
| REFERENCË:   | 457/2021   |            |   |        |            |
| PËR/ZA/TO:   | Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme – Zyra Kombëtare e Auditimit                             |            |   |        |            |
| CC:  | Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – MPJD   |            |   |        |            |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |  |            |   |        |            |
| NGA/OD/FROM:   | Donika Gërvalla-Schwarz, Ministre e Punëve të Jashtme dhe Diasporës                            |            |   |        |            |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:                                       | Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e auditimit të performancës |            |   |        |            |
| Nr. i zyrës:   | 401  | Lokacioni: | Rr. "Luan Haradinaj",<br>10000, Prishtinë | Data:  | 24.11.2021 |
| Br. kancelarije:   |  | Kueni:     |   | Datum: |            |
| Room No.:  |  | Extension: |   | Date:  |            |
| PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION                        |  |            |   |        | X          |
| PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION |  |            |   |        | X          |
| AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE:                                   |  |            |   |        | X          |

E nderuara znj. Spanca,

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka pranuar raportin përfundimtar të auditimit të performancës "Kontratat e centralizuara - Shërbimet e transportit ajror", nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Bazuar në Ligjin nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit, kemi përgatitur dhe po ju dërgojmë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport, për të gjeturat dhe rekomandimet që përfshijnë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës

Jam plotësisht e vendosur për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të përgjithshëm dhe e përkushtuar për vendosjen e rregullit dhe të disiplinës financiare, si dhe për ngritjen e përgjegjësisë së kontrollit të brendshëm në kuadër të MPJD-së gjatë shpenzimit të parashë publike.

Me respekt!

| Nr. | Rekomandimi  | Veprimet e ndërmarra apo të planifikuara për tu ndërmarrë  | Zyrtari/ët përgjegjës          | Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit |
|-----|--|--|--------------------------------|---|
| 1   | Të përdorin klasën ekonomike për t'i shmangur shpenzimet e larta të transportit ajror, me përjashtim të rasteve kur UA i rishikuar do të lejonte shfrytëzimin e klasave tjera; | Përmes rritjes së nivelit të mbikqyrjes sigurohet që gjatë rezervimeve të biletave të përdoren vetëm kategoritë/klasat e lejuara me rregullat e përcaktuara për udhëtime zyrtare. Nga menaxheri i kontratës është kërkuar në formë strikte që të mos bëjë asnjë rezervim të biletave jashtë klasës së lejuar pa një shqyrtim dhe miratim paraprak nga Sekretari i Përgjithshëm i MPJD-së. Drejtorët e departamenteve përkatëse janë udhëzuar që miratimin e udhëtimeve të vartësve të tyre ta bëjnë vetëm në rastet, kur një udhëtim i tillë është i pashmangshëm. Miratimi përfundimtar bëhet nga Sekretari i Përgjithshëm. | ZKA,<br>Menaxheri i kontratës. | TM4_2021                                      |
| 2   | Të planifikojnë udhëtimet më mirë në mënyrë që të shmangin nevojën për anulime dhe shtyrje të udhëtimeve.  | Do të rritet niveli i kontrollit në këtë sistem, duke kërkuar nga zyrtarët që, në rastet e udhëtimit/pjesëmarrjes në takime/aktivitete, të bëhet një planifikim më i mirë i agjendës, në mënyrë që të mos bëhet anulimi i biletave të rezervuara dhe të mos krijohen shpenzime të paarsyetuara.  | ZKA,<br>Menaxheri i kontratës. | TM4_2021                                      |